Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**01.02.2023**	**06.02.2023**	**2023/0053**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me daten: 27.01.2023, OE “"Internat Security Association"SH.P.K.”- Prishtine, ka parashtruar ankese me nr: 2023/0053, kunder anulimit te aktivitetit te prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi fizik i objekteve te Komunes se Gjakoves” me nr. te prokurimit: "632-22-6005-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: , shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 340,000€. Konform nenit 113, 114 te Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotesuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7

Neni 59

Te Nderuar

Kompania Private e Sigurimit International Security Association sh.p.k, ka marrë pjesë në tenderin e shpallur nga AKme titull: **Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës** dhe me nr.prokurimi **632-22-6005-2-1-1**, Ne kemi ofruar ofertën tonë e cila është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e juaja bazuar në kërkesat të cilat janë evidente në dosjen e tenderit, dhe në ANEKS 1 të dosjes së tenderit specifikacionet teknike të detyrueshme.

Andaj bazuar në kërkesat e juaja ne konisderojmë se ne kemi plotësuar të gjitha kushtet si ato administrative e poashtu edhe financiare në ofertën tonë dhe mendojmë se na është bërë e padrejtë në këtë AP arsyetimi për eliminim të kompanisë sonë me arsyetimin se kemi tejkaluar buxhetin e parashikuar të paraparë nga AK.

Detajet dhe faktet :

AK në dosjen e tenderit keni kërkuar që secili OE pjesëmarrës të deklarohet se do të paguajë vlerën e pagave prej 280 euro netto pagë për secilin punëtor të angazhuar në projekt dhe numri i caktuar i punëtorëve nga AK për realizimin e këtij projekti ka qenë 38 punëtor, andaj ne na është dashtë që të kalkulojmë cmimin e ofertës sonë për 38 punëtor x 280 euro netto pagë dhe poashtu të kalkulojmë edhe të gjitha taksat e pagueshme për pagat si kontributi nba punëmarrësi dhe punëdhënësi dhe tatimi në pagë, taksa të obligueshme.

Duke u bazuar në këto kërkesa :

" Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se

punëtorëve do t'iu paguaj pagën neto minimum 280,00€.

Si dhe numri i punëtorëve 38 punëtor gjithsej "

Ne kemi kalkuluar si më poshtë :

a. Paga netto bazë 280 euro

b. Kontributi nga punëmarrësi dhe punëdhënësi 5+5% = 10% që në total është

c. 15.26+15.26= 30.52 euro

d. A+b= 280+30.52=310.52 euro

e. Tatimi në pagë 10 euro që në total i bie d+e=310.52+10=320.52

Kur kalkulojmë pagat 320.52*38 punëtor sigurimi të kërkuar nga AK 12179.87 euro.

Kontrata e parashikuar për 24 muaj apo dy vite pra 24*12179.87=292317.00 euro

Pasi kemi bërë këtë kalkulim të pagave për 24 muaj duhet ti shtohet edhe TVSH 18% pasi që është taksë e obigueshme për kompaninë tonë pasi ne jemi deklarues të TVSH së, 292317.00 euro plus tvsh 18% = 344934.00 euro që faktikisht është mbi buxhet por jo më shumë se 30% e sasisë së lejuar për devijim,

Në dosjen e tenderit të përshkrimi i cmimeve AK ka vendosur orët totale për 24 muaj për të gjitha vendrojet e që janë : 151424 orë total për dy vite ne kur kemi vendosur cmimin kemi pjestuar 344934.00 euro /151424 orë = 2.277935 euro, mirëpo duke pas parasysh se në prokurim nuk lejohet të vendosen më shumë se dy numra pas presjes dhjetore ne kemi rrumbullaksuar cmimin në 2.28 euro si në tabelën më poshtë për të mos dal me cmimin e dhënë nën paga e caktuara nga AK. Me këtë cmim ne kemi kalkuluar edhe një fitim simbolik të kompanisë dhe kjo nuk mund të arsyetohet me eliminim të kompanisë sonë pasi që AK vetë i ka

vendosur kërkesat për numrin dhe pagat e punëtorëve dhe ne nuk kemi mundur të kalkulojmë paga të cilat nuk mund ti plotësojmë pasi që jemi zotuar me deklaratë me shkrim të vulosur e vërtetuar se do ti përmbahemi kësaj kërkese, andaj mendojmë se na është bërë e padrejtë dhe jemi eliminuar padrejtëishtë nga AK andaj ju lutem që të keni parasysh këtë ankesë ndaj vendimit të marrë nga AK dhe lënda të kthehet në rivlersim,

Tabela e përshkrimit të cmimit si dëshmi se pse kemi ardhur deri të ky cmim me faktet e lartëshëhnuara.

Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës					
Nr.	**Përshkrimi**	**Njësia Matës e**	**Sasia**	**Çmimi njësi me TVSH**	**Çmimi total meTVSH**
1	Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës	orë	151424	2.28	345,246.72
Gjithsej totali me TVSH					**345,246.72**

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*

	teknike dhe/ose profesionale		**Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka** **përfunduar me sukses kontrata të natyrës së** **ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar** **nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.** **Në një vlerë prej jo më pak se 510.000,00€, në rast** **konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60%** **kontrata të natyrës së ngjajshme.** **Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 38 (tridhjetë e tetë punëtor me licenca të sigurimit themelor,licenca të jetë valide) punëtorë si dhe staf të mjaftueshëm për kryerjen e projektit si ne vijim a) Një Menaxher I shërbimit themelor me diplome universitare, trust pensional, licence të menaxherit nga**	**Lista e kontratave në të cilën specifikohen të** **gjitha punët e realizuara në 3 (tri) vitet e** **shkuara, duke saktësuar sherbimet e kryera** **shumën e kontratës, datën e pranuesit ose** **certifikatën e ekzekutimit të mire të sherbimëve –** **(referencë ose raport të pranimit të punëve e** **cila përputhet me listën e dorëzuar), në rast se** **Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe** **referenca me Operator Ekonomik privat** **atëherë Operatori Ekonomik duhet të** **prezanton situacionet e nënshkruara së bashku** **me transaksionin bankar, që përputhen me të** **njëjtën kontratë-referencë.** **Lista e kualifikimeve shkollore dhe**	

			MPB (5 vite provoj pune) b.) Një Menaxher për vezhgim dhe monitorim elektronik shkolla e mesme licence të jetë valide,c.) Një Menaxher për siguri dhe shendet ne pune certifikata nga MPMS, kontrat apo marreveshje per angazhim , trust pensional,d.) Një Mbikqyrës të vezhgimit elektronik me licens valide(OME).	profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin. si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani.	
			Operatori Ekonomik duhet të ofrojë	Memorandum, certifikata dhe licenca valide	

			Memorandum me ndonje kompani të licencuar për trajnimin e punëtorve-trajnim themelor professional dhe trajnim te specializuar, certifikata dhe licenca valide e institucionit trajnues	**e istitucionit trajnues (kopje)**	
			Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se punëtorëve do t'iu paguaj pagën neto minimum 280,00€.	**Deklarata e nënshkruat dhe vërtetuar.**	
			Për pikat me siper Autoriteti Kontraktues mund të bëjë verifikimin e çdo dokumenti si dhe inspektimin e kapaciteteve teknike e profesionale të gjithë operatorëve ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit. Nëse operatori		

			ekonomik ka paraqitur të dhëna të rrejshme automatikisht do të eliminohet nga vlerësimi dhe oferta e tij do të konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme.		

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar [3]

Gjakovë 12.01.2023

Komuna e Gjakovës, Rruga UÇK (ndërtesa e ish Bankosit) Zyra e Prokurimit kati I-rë Gjakovë

Për: **"Internat Security Association"SH.P.K., Mustafë Kruja nr.3, 10000, PRISHTINË**

Nr. i prokurimit	**632-22-6005-2-1-1**
Nr i brendshëm	**632-22-052-2-1-1**

Titulli: Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës

I nderuar Z.

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM
Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :
- Ju si Operator Ekonomik keni tejkaluar vlerën e parashikuar.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

_____, _____

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"Internat Security Association"SH.P.K.**

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës 53/23 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-KK Gjakovë OE ankues ka tejkaluar vlerën/buxhetin e parashikuar nga AK prej 340,000€. Konkretisht OE ankues ka ofruar cmim 345,246.72€.

OE ankues përmes ankesës e pranon se cmimi ti tij është mbi buxhetin e planifikuar të AK-së, me gjithë atë më tutje pretendon se nuk e tejkalon 30% e sasisë së lejuar për devijim.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore, kërkesave të dosjes dhe vlerësimit të AK-së, mendimi ekspertit shqyrtues është se cmimi I OE ankues tejkalon vlerën e parashikuar dhe në pajtim me nenin 62 të LPP-së AK ka zgjedhur të anuloj procedurën e prokurimit.

Pretendimi I OE se cmimi tij nuk tejkalon 30% të devijimit te lejuar vlerësojmë se është I paqëndrueshëm, pasi vlera e parashikuar e qdo prokurimi bëhet për 100% të sasive, e jo për 70% ose 130% të sasive të parashikuar.

Më tutje sqarojmë se sipas kalkulimeve tona vlera e parashikuar nga prej 340,000€ e bënë të pamundur realizimin e kësaj kontrate, për arsye se vlera minimale e nevojshme për të mbuluar vetëm pagat neto prej 280€ neto tejkalon shumën 344,000€ (ashtu si ka vepruar OE ankues).

Në këto rrethana qdo OE që ofron cmim edhe 100% sipas vlerës të parashikuar nga AK ose më të ulët nuk do të arrijë të mbuloj pagat e punëtorëve, ndërsa qdo OE që ofron cmim i cili mbulon pagat e punëtorëve prej 280€ neto do të tejkaloj vlerën e parashikuar nga AK dhe të njëjtit mund të eliminohen ashtu si ka vepruar AK me OE tjerë.

Vlerësojmë se planifikimi i këtij prokurimi dhe parashikimi i vlerës nuk është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 17 par.1 të LPP-së dhe sipas mendimit tonë e bënë të pamundur të shpërblehet me kontratë cili do OE pavarësisht cmimit që ofron ai.

Sipas mendimit të ekspertit OE ankues në asnjë rrethanë nuk mund të jetë fitues i kësaj kontrate derisa AK ka zgjedhur të alpikoj nenin 62 të LPP-së për përfundimin e një aktiviteti, edhe pse përgjëgjësia kryesore për pamundësimin e realizimit të këtij prokurimi bie mbi autoritetin kontratues, vlerësimi dhe rekomandimi jonë është që ankesa e OE ankues të hudhet e palejuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E GJAKOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **"Internat Security Association"SH.P.K.**

Ilir Halili

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TEKNIKA RAZMATRANJE NABAVIKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA